



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2023:240106

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05838557

CN.249/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, gjykatësi Dr.sc. Rafet Haxhaj, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike jokontestimore të propozueses J. S, me adresë në Vushtrri, ndaj kundërpropozuesve R. S me vendbanim në Gjermani dhe A. P ish nga Vushtrria, tani me adresë të panjohur, për shpalljen se fëmija ka lindur në martesë, duke vendosur lidhur me propozimin për përsëritjen e procedurës, i parashtruar nga paditësja, me datë 19.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

HEDHET si i pa lejuar propozimi për përsëritjen e procedurës i datës 21.12.2023, i parashtruar nga propozuesja J. S sipas lëndës CN.nr.129/2023.

**A r s y e t i m**

Propozuesja J. S, në gjykatën e shkallës së parë me datë 21.12.2023 ka parashtruar propozimin për përsëritjen e procedurës sipas lëndës CN.nr.129/2023 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, me propozim që ti lejohet përsëritja e procedurës.

Gjykatësi i vetëm i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, ka bërë shqyrtimin e shkresave të lëndës në pajtim me dispozitat e nenit 239.1 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të thënieve në propozim ka gjetur se:

Propozimi duhet të hedhet si i pa lejuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhe se propozuesja J. S në gjykatën e shkallës së parë me datë 07.11.2023 ka parashtruar propozimin për shpalljen se fëmija ka lindur në martesë. Pala

parashtruese e propozimit ka theksuar se e njëjta duke qenë se lënda është e natyrës statusore ka parashtruar një kërkesë për shqyrtimin më të shpejtë të rastit për shkak të prioritetit ligjor të këtyre rasteve, por me rastin e dorëzimit të parashtrësës me datë 12.12.2023 siç ka theksuar në propozim gjykata me një njoftim verbal e ka njoftuar se lënda ka përfunduar me aktvendim të formës së prerë. Propozuesja ka theksuar se nuk ka njohuri se si gjykata pa ftuar fare dhe pa i dërguar fare aktvendimin, me të cilin është vendosur jashtë seancës gjyqësore, i ka vënë vulën e plotfuqishmërisë, duke ia mohuar të drejtën e ankesës kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë. Sipas pretendimeve të propozueses e njëjta nuk është ftuar në mënyrë të rregullt në seancë andaj me këtë pala propozuese konsideron qe janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për përsëritjen e procedurën bazuar në nenin 232 par.1, pika a) të LPK-së.

Gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Apelit pas analizimit të shkresave të lëndës ka gjetur se në këtë çështje pala propozues ka ushtruar Propozim për shpalljen se fëmija ka lindur në martesë gjegjësisht në bashkësinë jashtëmartesore të prindërve R. S dhe A. P me datën 13.06.1973, por për shkak se e njëjta kishte lindur në kushte shtëpie dhe prindërit e saj nuk kishin të lidhur martesë ligjore, kjo për shkak të neglizhencës së prindërve të saj, nuk është regjistruar në zyrën e gjendjes civile. Kjo edhe për faktin se nëna e saj A. P e ka lëshuar Kosovën ka dalë në Botën e jashtme dhe më nuk kanë pasur asnjëherë kontakt prindërit me qëllim që ta regjistrojnë fëmiun e tyre në Zyrën e Gjendjes Civile. Propozuesja në Botën e jashtme ka krijuar jetën e saj dhe ka leje qëndrimi të përhershëm në Gjermani dhe meqenëse nuk është regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile në Kosovë ka kërkuar nga gjykata që në kuptim të nenit 100 par. 1 të Ligjit për Familjen të marr aktvendim, ashtu që të aprovohet propozimi i propozesës J. S si i bazuar dhe të vërtetohet që propozuesja J. S e lindur me datë ... në Vushtrri tani me vendbanim në Gjermani është e lindur nga babai R. S i lindur me datë ... në ... Komuna e Mitrovicës dhe nëna A. P e lindur me datë ... në Vushtrri. Të urdhërohet Zyra e Gjendjes Civile në Vushtrri të bëjë regjistrimin e propozueses J. S, në Librin Amëz të të Lindurve dhe atë me të dhënat: J. S e lindur me datë ... në Vushtrri tani me vendbanim në Gjermani-Nurnberg është e lindur nga babai R. S i lindur me datë ... në ... Komuna e Mitrovicës tani nga Vushtrria dhe nëna A. P e lindur me datë ... në Vushtrri tani me adresë të panjohur.

Gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Apelit ka gjetur se, Aktvendimi i Gjykatës të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri CN.nr.129/2023, i datës 09.11.2023 ka marrë klauzolën e plotfuqishmërisë më datën 04.12.2023. Në nenin 28.1 të Ligjit të Procedurës Jokontestimore, është përcaktuar se: *“Kundër aktvendimit meritor të formës së prerë nuk mund të paraqitet propozimi për përsëritjen e procedurës po qe se pjesëmarrësit të procedurës jokontestimore me këtë ligj apo me ndonjë ligj tjetër i është njohur e drejta që kërkesën e tij për të cilën është vendosur me aktvendim ta realizojë në procedurën kontestimore apo në procesin përpara organit administrativ”.*

Për arsyet e dhëna si më lartë gjyqtari i vetëm i Gjykatë së Apelit, ka ardhur në përfundim se propozimi i propozueses duhet të hedhet si i pa lejuar.

Nga sa u tha më sipër e bazuar në dispozitat e nenit 239.1 të LPK-së dhe nenit 28.1 të LPJK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT NË PRISHTINË, CN.249/23, me datë 19.06.2024.

UDHËZIMI PËR MJETIN JURIDIK:

Kundër këtij Aktvendimi,

në pajtim me dispozitat e nenit 240 al.4 të LPK

është e lejuar ankesa e cila i paraqitet kësaj gjykate.

GJYKATËSI,

Dr.sc. Rafet Haxhaj